

Të drejtat dhe përgjegjësitë e pacientit

Si pacient, keni të drejtë:

Aksesi në kujdes të respektueshëm shëndetësor

- Të merrni kujdes të nevojshëm pavarësisht racës, gjinisë (përfshirë identitetin dhe shprehjen gjinore), ngjyrës, fesë, besimit, origjinës kombëtare ose prejardhjes, moshës, gjendjes civile, orientimit seksual, aftësive të kufizuara, statusit të veçantë të veteranit të luftës ose të epokës së Vietnamit dhe gjatësisë apo peshës suaj. Akomodim i arsyeshëm do t'u ofrohet personave me aftësi të kufizuara dhe veteranëve të luftës, si dhe për arsye të praktikave fetare.
- Merrni kujdes të vëmendshëm dhe të respektueshëm në një ambient ku nuk lejohet duhani
- Nëse siguruesi juaj i kujdesit shëndetësor nuk ka përcaktuar se nuk është në interesin tuaj më të mirë mjekësor, bisedimit vetëm për vetëm me këdo që dëshironi gjatë qëndrimit në spitale ose në qendrat shëndetësore.
- Zgjedhjes se kush mund t'ju vizitojë gjatë shtrimit tuaj në spital, pavarësisht nëse vizitori është pjesëtar i familjes, bashkëshort/e, partner me të cilin bashkëjetoni (përfshirë këtu partner të së njëjtës gjini) ose çdo lloj tjetër vizitori, vetëm nëse prania e tij nuk rrezikon të drejtat, sigurinë ose shëndetin tuaj apo të tjerëve. Ju keni të drejtë të tërhiqni një miratim të tillë për vizita në çdo kohë. Nëse pacienti është minoren, janë prindërit ose kujdestarët ligjorë që kanë këtë të drejtë.
- Të merrni informacion mbi rregullat që përfshijnë kujdesin ose sjelljen tuaj.
- Vlerësimi të duhur dhe trajtimi të dhimbjes.
- Të jeni i lirë nga kufizimet e çdo lloj forme apo izolimi që nuk është i nevojshëm nga ana mjekësore ose si mjet izolimi, disipline, lehtësie apo hakmarrjeje nga personeli.
- Të jeni i lirë nga abuzimi, neglizhenca dhe shfrytëzimi mendor, fizik, seksual dhe verbal.
- Të flisni ose të takoheni me klerikun sipas zgjedhjes suaj.
- Aksesi në shërbimet e mbrojtjes dhe përkrahjes.
- Të kërkoni një konsultim me komunitetin e etikës për udhëzimin për vendimarrjen rreth kujdesit shëndetësor duke kontaktuar operatorin e spitalit në numrin 734-936-4000 dhe duke kërkuar për konsulentin e etikës për komitetin e etikës së të rriturve ose atë pediatrik.
- Privatësie.

Përfshirja në vendimet e kujdesit

- Të informoni një pjesëtar të familjes ose përfaqësues tjetër për hyrjen tuaj në spital.

- Informacioni mbi diagnozën, gjendjen shëndetësore, gjendjen, trajtimin, prognozën dhe rezultatet e papritura të kujdesit tuaj.
- Njohuri për personin që po kujdeset për ju dhe titujt e tij profesionalë.
- Edukimi mbi përdorimin e sigurt të mjekimeve, pajisjeve mjekësore, ndërveprimeve të mundshme të drogës-ushqimit dhe këshillimit për të ushqyerit dhe dietat e modifikuara.
- Të përfshiheni në planifikimin, plotësimin dhe shqyrtimin e planit tuaj të kujdesit, duke përfshirë trajtimin e dhimbjes dhe planin tuaj të kujdesit pasi të largoheni nga UMHS.
- Të refuzoni trajtimin deri në masën e lejuar nga ligji. Është përgjegjësia jonë të diskutojnë me ju rreth rezultateve të mundshme të refuzimit tuaj.
- Pjesëmarrjeje në vendimet e kujdesit shëndetësor dhe dhënies së informacionit nga personi i spitalit mbi direktivat për masat vijuese dhe përmbushjes së dëshirave tuaja në përputhje me ligjin.
- Kërkesë për trajtim. Megjithatë, e drejta juaj për të marrë vendime mbi kujdesin shëndetësor nuk do të thotë se mund të kërkonti trajtim ose shërbime të papërshtatshme ose të panevojshme nga ana mjekësore.
- Informacioni në lidhje me procedurat e kërkimit të propozuara si pjesë e kujdesit tuaj. Ju keni të drejtë të refuzoni të merrni pjesë në kërkim pa rrezikuar aksesin tuaj në kujdes të vazhdueshëm.

Kartela mjekësore

- Të shikoni kartelën tuaj mjekësore në një kohë të përshtatshme si për ju, ashtu dhe për personelin. Pasi të dilni, mund të kërkonti dhe të merrni një kopje të kartelës suaj mjekësore për një tarifë të arsyeshme, duke telefonuar njësinë e dhënies së informacionit në numrin e telefonit (734) 936-5490.
- Të kërkonti ndryshime në informacionin tuaj të mbrojtur shëndetësor (protected health information (PHI)). Ju keni të drejtë të kërkonti që informacioni juaj të mos jepet, duke kontaktuar me njësinë e dhënies së informacionit.
- Konfidencialiteti, privatësia dhe siguria të të dhënave tuaja, si ato personale, dhe ato mjekësore. Ne mund të përdorim ose të hapin PHI pa lejen tuaj, siç përshkruhet në Njoftimin e praktikave të privatësisë, për shembull për të koordinuar kujdesin tuaj ose për të paraqitur një ankesë në kompaninë tuaj të sigurimeve.
- Ju keni një numër të drejtash të tjera lidhur me të dhënat tuaja mjekësore, të cilat shpjegohen në Njoftimin e praktikave të privatësisë. Mund të merrni një kopje të Njoftimit të praktikave të privatësisë, duke telefonuar zyrën e sigurisë klinike në numrin e telefonit (877) 285-7788.

Shqetësim rreth kujdesit ose shërbimit

- Të keni informacion të kujdesit shëndetësor, të dhënë në një mënyrë dhe formë të kuptueshme nga ju.
- Të merrni kujdes në një mjedis të sigurt.
- Të shprehni shqetësime që mund të keni lidhur me kujdesin ose shërbimin. Ne ju nxitim t'u përcillni shqetësimet ose komplimentet individëve ose departamentit të përfshirë.
- Të ngrini zërin për të identifikuar situata të pakëndshme, ngatërresë në shërbimin e dhënë ose që pritet të jepet apo për probleme ku janë identifikuar shqetësime reale ose të vërteta të sigurisë. Edhe kujdestarët ligjorë, edhe vizitorët e kanë këtë të drejtë.
- Të paraqitni një ankesë me shkrim ose verbale në zyrën e sigurisë klinike, nëse siguruesit tuaj të kujdesit shëndetësor nuk mund të zgjidhin menjëherë shqetësimet tuaja. Mund të kontaktoni zyrën e sigurisë klinike duke telefonuar në numrin (877) 285-7788 ose duke na shkruar në adresën 300 North Ingalls Street, Room 8A06, Ann Arbor, MI 48109-5478.
- Të paraqitni një ankesë në një prej organizatave të mëposhtme, pavarësisht nëse zgjidhja e shqetësimit tuaj nga UMHS është e kënaqshme:
 - **Michigan Department of Licensing and Regulatory Affairs (LARA), Health Facilities Division**, P.O. Box 30664, Lansing, MI 48909, **800-882-6006 (numër pa pagesë)**.
 - **KEPRO, Medicare Quality of Care Complaints** [KEPRO Area 4 - Illinois, Indiana, Iowa, Kansas, Michigan, Minnesota, Missouri, Nebraska, Ohio, Wisconsin], 5201 W. Kennedy Blvd., Suite 900, Tampa, FL 33609, **855-408-8557 (numër pa pagesë)**.
 - **The Joint Commission – Zyra e monitorimit të cilësisë**, One Renaissance Boulevard, Oakbrook Terrace, IL 60181, **800- 994-6610 (numër pa pagesë)**.

Shqetësime rreth faturimit

- Të detajeve mbi të gjithë artikujt në faturën tuaj. Me kërkesën tuaj, do t'ju jepet informacion në lidhje me ndihmën financiare. Nëse keni pyetje rreth faturimit ose sigurimit, telefoni në numrin 800-992-9475.

Si pacient, jeni të përgjegjshëm për:

- Respektimin e rregullave që përfshijnë kujdesin ose sjelljen tuaj. Këto përfshijnë vizitat në UMHS dhe politikat kundës pirjes së duhanit.
- Dhënien e një historiku të plotë dhe të saktë mjekësor. Ky historik duhet të përfshijë të gjitha mjekimet e dhëna me recetë ose të blera me pakicë që po merrni.
- Të na treguar rreth të gjitha trajtimeve dhe ndërhyrjeve ku jeni të përfshirë.
- Për të ndjekur sugjerimet dhe këshillat e dhëna nga siguruesit tuaj të kujdesit shëndetësor në një kurs trajtimi. Nëse refuzimi juaj për trajtimin na pengon të sigurojmë kujdes të përshtatshme sipas standardeve etike dhe profesionale, pasi t'ju kemi dhënë një njoftim të arsyeshëm, mund të na duhet t'i japim fund marrëdhënies tonë.
- Lënien e objekteve me vlerë në shtëpi dhe sjelljen vetëm të artikujve të nevojshëm për qëndrimin në spital. Spitali nuk është përgjegjës për humbjen ose vjedhjen e objekteve me vlerë.
- Të qenit i kujdesshëm ndaj të drejtave të pacientëve të tjerë, si dhe të stafit dhe pronës së UMHS.
- Dhënien e informacionit rreth vështirësive të papritura që mund të keni në lidhje me kujdesin tuaj shëndetësor.
- Të na tregoni nëse e kuptoni qartë planin tuaj të kujdesit dhe gjërat që ju janë kërkuar të bëni.
- Caktimin e takimeve dhe ardhjen në orar. Nëse nuk mund t'i përmbaheni një takimi të planifikuar, duhet të telefononi paraprakisht.
- Përmbushjen e detyrimeve financiare të rëna dakord me spitalet dhe qendrat shëndetësore, duke përfshirë dhënien e informacionit rreth burimeve të juaja të pagesës dhe mundësisë për të paguar faturën tuaj.